



Pranimi / Dostava Prilohet / Prilohet Received / Received		10. 01 2024	4	viti Year
Organizata Organizational Organi Organi	Id. Prot. Id. Prot. Prot. No.	Shtesa Parte Appendix	Sasia Koliciteti Quantity	
SKPMSTOK 193/2024			1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1445/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtës, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1445/2023 të datës 27.11.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1445/2023 e datës 27.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (tutje referuar vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 22.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1434/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1445/2023 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me pretendimin ankimor se kategorizimi i tij në klasën "Profesional 3" është bërë pa bazë juridike ngase klasifikimi i saj duhet të bëhet si "Profesional 2".

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Kjo e fundit, më datë 12.12.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e parakohshme, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitroviës së Jugut dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 01.11.2013 me shifër:01-112/27827, ushtron pozitën e punës "Zyrtar i Gjendjes Civile".

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton së ankuesi ka realizuar koeficient gjashtë (6) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është duke realizuar pagën sipas klasës "Profesional 3", me koeficient të pagës GJ43-3.96.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së klasifikimi në klasën "Profesional 3", është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe se ankuesi ka pësuar dëm si mungesë e ekuivalencës në koeficient. Në vlerësimin e ankuesit pozita e tij duhet të klasifikohet në "Profesional 2".

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast, në pajtim me Ligjin përkatës për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë "Profesional 2" është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore. Rrjedhimisht, e njëjta,

është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1434/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

